



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.06.2019, ora 15:30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me grupet e interesit Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë dhe Dhoma Amerikane e Tregtisë për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Senida Mesi, Blerina Gjylameti, Krenar Ryci, Nikolin Staka, Ervin Bushati, Anastas Angjeli, Reme Lala dhe Artur Roshi

Mungojnë:

Artemis Dralo (Malo), Vullnet Sinaj dhe Edlira Hyseni.

Të ftuar:

Vullnet Haka - Anëtar i Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë

Dionis Teqja - Anëtar i Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë

Monika Dhamo – Anëtare e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë

Ilir Trimi - Drejtori Ekzekutiv i AmCham Albania në Dhomën Amerikanë të Tregtisë

Alketa Uruçi - Kryetare e Komitetit të Taksave dhe Doganave në Dhomën Amerikanë të Tregtisë

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëdita!

Sot kemi organizuar një seancë dëgjimore me grupet e interesit Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë dhe Dhoma Amerikane e Tregtisë për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare””, i cili është ndryshuar në dhjetor të vitit 2018. Ka një kërkesë nga grupe të ndryshme të interesit nga të dyja palët, një kërkesë nga prodhuesit shqiptarë, për të vazhduar me diferencimin dhe një kërkesë po aq të fortë nga importuesit që të ruhet balanca në mënyrë transparente midis importit dhe prodhimit vendas. Në të njëjtën kohë ka një kërkesë edhe nga shoqata e konsumatorëve, të cilët lehtësohen nga reflektimi i politikave fiskale në xhepat e tyre.

Të ftuar në komision nga Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë janë zoti Vullnet Haka, zoti Dionis Teqja dhe zonja Monika Dhomo, anëtare. Nga Dhoma Amerikane e Tregtisë të pranishëm janë zonja Alketa Uruçi dhe zoti Ilir Trimi, Drejtor Ekzekutiv i AmCham Albania.

Unë do t’ju sugjeroja që fjalën ta marrë zoti Vullnet. Do t’ju lutesha që në harkun kohor prej 5 minutash të na thoni qëndrimin tuaj dhe më pas nëse do të ketë pyetje, debat apo diskutim mund ta merrni fjalën sërish.

Vullnet Haka – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zotërinj deputetë që na dhatë mundësinë për t’u dëgjuar sa u takon ndryshimeve të kërkuara nga ana jonë!

Amendimi që iu bë ligjit për taksat kombëtare, konkretisht për taksën e plastikës nga 25 lekë për kilogram mbi lëndët e para, ne kemi propozuar dhe kërkojmë me insistim që kjo taksë nga niveli 25 lekë për kilogram të shkojë në nivelin 5 lekë për kilogram.

Po t’i referohemi nivelit të taksimit në vlerë mbi lëndën e parë, pra po të marrim çmimet referuese që janë sot në bursë, të cilat janë pak a shumë...

Arben Ahmetaj – Më falni, 25 lekë për kilogram që ju thatë, cilës i referoheni?

Vullnet Haka – 25 lekë për kilogram është taksë që duhet të paguajë sot një prodhues në vend kur importon lëndën e parë nga jashtë në doganë...

Arben Ahmetaj – Ju pyeta me qëllimin që anëtarët e komisionit t’i referohen lëndës së parë.

Vullnet Haka – Bëhet fjalë për lëndën e parë granol, e cila vjen dhe përpunohet, ka firo teknologjike, si dhe kohën e qëndrimit në procesin e prodhimit, në stokim në të gjithë ciklin e vet deri sa të tregtohet...

Arben Ahmetaj – Sa janë firo e lëndës së parë në standardin e industrisë ndërkombëtare?

Vullnet Haka – Firo fillojnë nga 2-3% dhe shkojnë deri në 10-11% në varësi të llojit të biznesit...

Arben Ahmetaj - A mund të na e shpjegoni se çfarë do të thotë “firo” në rastin konkret?

Vullnet Haka – Firo është një pjesë e lëndës së parë që nuk kthehet më dhe një pjesë është lënda e parë, e cila pas procesit të firove edhe nëse ruhet si masë nuk është më në atë cilësi dhe në atë standard për t’u përdorur, por shkon në përdorim me një vlerë tjetër.

Arben Ahmetaj – Pra, nuk është firo *per se*, në aspektin fiskal, por është një material i degraduar.

Vullnet Haka – Një pjesë humbet dhe një pjesë bie në vlerë.

Arben Ahmetaj – Sa është ajo që humbet në standardin e industrisë? A mund të na e sillni standardin e industrisë të shkruar në mënyrë që ne si komision ta shohim dhe ta krahasojmë me industrinë në botë?

Vullnet Haka – Po, ne do t’ia depozitojmë si standard komisionit dhe më pas...

Arben Ahmetaj – Vetëm na i depozitoni.

Vullnet Haka – Zoti kryetar, ajo që doja t’ju thosha që në fillim dhe që bie në sy menjëherë është, nëse do të krahasojmë taksimin me 35 lekë të produkteve të gatshme që vijnë nga importi në vlerë mbi vlerën e këtyre produkteve, del që 35 lekë mbi vlerën e këtyre produkteve me një mesatare që është marrë, taksimi është diku në vlerën 15%. Po ta taksosh me 25 lekë lëndën e parë në vlerë që vjen për t’u prodhuar, këtu i bie diku te 15%.

Pra, kemi një diskriminim të prodhuesve vendas...

Arben Ahmetaj – A mund të na e depozitoni edhe këtë ushtrim fiskal dhe kontabël në lidhje me kostot që komisioni ta marrë në *e-mail* dhe të na bëni një shembull të një produkti të gatshëm dhe një shembull të lëndës së parë të transformuar për të arritur në konkluzionin se si kjo del 15% dhe sa është pjesa tjetër?

Vullnet Haka – Ky shembull që ju po kërkon do t’ju vijë patjetër, por kjo gjë është depozituar në muajin dhjetor kur është bërë seanca dëgjimore me Komisionin e Veprimtarisë

Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit. Për fat të keq në atë kohë Komisioni i Ekonomisë dhe Financave nuk na priti në seancë dëgjimore dhe me aq sa ne kemi dijeni pas dëgjësave që Komisioni i Veprimtarive Prodhuese ka bërë me ne është proceduar me një propozim, që taksa për produktet e gatshme nga importi nga 35 lekë të bëhej 40 lekë dhe taksa për lëndën e parë nga 25 lekë që ishte propozimi të bëhej 10 lekë. Fatkeqësisht, kjo gjë nuk është marrë parasysh, por urojmë meqë sot jemi prapë në diskutim për këtë çështje të kemi mundësi...

Arben Ahmetaj – Do t'ju lutesha të na depozitoni shembullin specifik dhe besoj se komisioni do të organizojë një ushtrim të vetin për ta parë konkretisht në prodhim, gjë që do ta debatojmë edhe me importues se si referohet shpërndarja e kostos siç ju referuat në 15% në një rast dhe sa për qind ishte për rastin tjetër?

Vullnet Haka – 15% për produktet e gatshme nga importi dhe 20% mbi lëndën e parë, duke folur gjithmonë në vlerë.

Arben Ahmetaj – Dua ta kuptoj personalisht se si bëhet kjo, sepse jam pak i paqartë, por besoj se edhe anëtarët e komisionit do të ishin...

Vullnet Haka – Nëse e doni shkurtimisht mund t'ju them tani...

Arben Ahmetaj – Jo, e dua të shkruar që komisioni të kalojë në një vlerësim të kuantifikuar dhe të detajuar.

Vullnet Haka – Unë sapo jua thashë që këtë lloj ushtrimi patjetër do t'ju depozitojmë, por e kemi depozituar edhe te Komisioni i Veprimtarive Prodhuese.

Dua t'i kthehem pak qëndrimit që mbajti Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, ku ndër të tjera jo vetëm propozoi rritjen prej 5 lekësh të taksës së importit dhe uli me 15 lekë taksën për lëndën e parë në import, por u shpreh se ishte përpara një vendimmarrje të panjohur.

Pra, jo vetëm deputetët e atij komisioni e kishin perceptuar këtë problematikë, por edhe ne që ishim pjesë e biznesit nuk e dinim që vendosja e kësaj takse do të afektonte jo vetëm prodhuesit e plastikës drejtpërdrejtë, por në të njëjtën kohë afektoi edhe gjithë industrinë e prodhimit të bojërave, sepse lëndët e para që ata përdorin në origjinën e tyre vjen nga plastika, nga produktet derivate të naftës dhe për rrjedhojë taksa ishte 25 lekë për kilogram, ndërkohë që produkti i gatshëm, boja e ndërtimit, kur vjen si produkt i përfunduar nuk futet tek Kodi 39 që merr këtë taksë. E gjithë industria e bojërave, e polisteroleve, e sfungjerit apo më tej, të cilët nuk e kishin menduar se do të afektoheshin nga kjo taksë në janar, e gjetën veten të ekspozuar

përballë një takse, e cila i nxirre nga tregu. Një pjese të tyre u rëndonte në sasi të madhe kostosh, kurse pjesës tjetër ia bënte të pamundur prodhimin.

Arben Ahmetaj – Më falni, t’ju bëj një pyetje ose më mirë mbaroni ju dhe më pas vazhdojmë me pyetjet!

Vullnet Haka – Në këto kushte dhe të vendosur në këtë situatë, ne, jo vetëm si shoqatë e konvertuesve të plastikës, por tashmë Bashkimi i Prodhuesve si një organizatë ombrellë e prodhimit shqiptar u vumë në lëvizje nga gjithë ky impakt i fortë që erdhi në të gjitha sipërmarrjet prodhuese. Propozimi që ne bëmë ishte që taksa për lëndët e para të prodhimit të produkteve plastike që janë 100% plastikë nga 25 lekë të ishte 5 lekë. Për produktet e tjera, të cilat janë lëndë e parë apo adediv, që shërbejnë për prodhimin e produkteve të tjera që në finale nuk janë plastikë të përjashtohen fare nga kjo taksë. Në atë kohë u nxor një udhëzim nga Ministria e Financave për ta zhbllokuar situatën, por ajo ishte diçka e momentit, sepse ai udhëzim kishte aq shumë burokraci dhe dokumentacion aq sa unë e kam krahasuar me letrat për të marrë një koncesion. Ne gjykojmë se është mjaft e rëndësishme që taksa për lëndën e parë të produkteve të plastikës, që përfundojnë si produkte plastike dhe që trajtohen te Kodi 39 i nomenklaturës së mallrave, të jetë me 5 lekë.

Përse kërkojmë me insistim që të jetë 5 lekë për kilogram mbi produktet që janë plastikë si lëndë e parë edhe kur përfundon si produkt i gatshëm?

Ne e kërkojmë këtë gjë, sepse nëse lënda e parë që importohet nuk ka një diferencë minimale si kjo që kërkojmë ne me produktet e gatshme që vijnë nga importi, bie interesi 100% për të investuar në linja prodhimi dhe për të prodhuar në Shqipëri. Minimalisht duhet të ketë një hapësirë të tillë që të ketë sens dhe në këtë mënyrë inkurajohet prodhimi dhe investorët në fushën e prodhimit.

Gjithashtu, kemi edhe një problematikë tjetër. Në momentin që ne importojmë lëndë të parë, granol plastik, për ta prodhuar në Shqipëri, 100% lënda e parë dhe prodhuesit e marrin këtë taksë, ndërkohë që ka një shmangie të fshehtë për të gjitha produktet që importohen dhe që kanë në përmbajtjen e tyre plastikë. Kjo përmbajtje mund të jetë 5%, por ka raste që mund të jetë 50 apo 70%. Por, nëse produkti ka një emërtim tjetër...

Arben Ahmetaj – A mund të na sillni një shembull?

Vullnet Haka - ... një shërbim apo një funksion tjetër Kodi i nomenklaturës nuk e klasifikon...

Arben Ahmetaj – A mund të na sillni një shembull, zoti Haka?

Vullnet Haka – Po, mund t’ju sjell një shembull, por sa ta përfundoj fjalinë.

Në këtë rast produkti që vjen nga importi për pjesën e plastikës që mbart nuk merr fare taksë. Nëse në Shqipëri do të kemi ndonjë prodhues që e prodhon atë produkt, i cili në përmbajtje ka të njëjtën plastikë, ai kur ta blejë nga prodhuesi i plastikës në vend e merr me taksën 25 lekë, sepse lënda e parë është taksuar dhe nuk ka shans t’i shmangesh, ndërsa kur produkti vjen nga importi kjo plastikë nuk taksohet.

Pra, ka një taksim të fshehtë që nuk duket, i cili e vë prodhimin vendas në një situatë shumë negative. Unë po ju sjell si shembull një palë këpucë që vijnë nga importi me shollë plastikë të inkorporuar D, këpuca është te Kodi 64, nuk e mbaj mend mirë, për shkak se është këpucë dhe nuk merret vesh nëse përmbajtja e saj ka plastikë apo jo, ajo kalon me zero taksë për plastikën që mbart. Nëse një nga fabrikat e këpucëve që ne kemi këtu, të cilat për fat të mirë nga fasonistë po kthehen në cikël të mbyllur, do të prodhojë këtu apo do të marrë te një prodhues shollat e plastikës, atëherë ai do t’i merrte me 25 lekë taksë plus, sepse lënda e parë kur është futur e ka marr këtë taksë. Kur vjen këpuca e përfunduar apo një karrige, e cila mund të jetë me skelet metalik, por mbajtësen, shpinoren dhe të gjitha materialet e tjera i ka plastikë, një prodhues i karrigeve këtu, të gjithë aksesorët, kur t’i blejë, do t’i blejë me taksën plus 25 lekë, por nëse vjen nga importi, nuk është e mundur që plastika që mbart ky produkt ta taksojmë, sepse realisht nuk taksohet dot.

Cila është mënyra që ne propozojmë? Ne propozojmë që për produktet e plastikës, që do të prodhohen në vend, të vendoset një taksë në një nivel 5 lekë për kilogram në raport me çmimin që ajo ka dhe del një përqindje, e cila nuk e prish planin e biznesit të asnjë prodhuesi. Nëse do të kalojmë mbi këtë nivel, atëherë të gjithë prodhuesit i kemi vënë në një pozicion të vështirë, të pamotivuar dhe kjo është arsyeja e dytë, përveç firove që përdorëm apo ciklit të gjatë që ka një prodhues për ta shitur produktin, prandaj kërkojmë që kjo taksë të jetë në këtë nivel.

Ne kemi plot argumente të tjera, pasi ne si industri punësojmë jo më pak se 20 000 veta në gjithë Shqipërinë. Në Shqipëri, në vit, importohen rreth 25 000-30 000 tonë plastikë granol dhe imagjiloni nëse një pjesë e madhe e ndërmarrjeve do të mbylleshin, nëse do të reduktonin aktivitetin apo do të ndërprisnin investimet për të qëndruar në koherencë me rinovimin e teknologjisë dëmi do të ishte fatal dhe i pamatshëm.

Arben Ahmetaj – Besoj se mbaruat, zoti Haka, apo keni ndonjë gjë tjetër?

Vullnet Haka – Kam akoma për t’ju thënë, por po e lë me kaq.

Arben Ahmetaj – Vullnet, nëse keni lënë ndonjë gjë pa thënë ju mund t’i riktheheni më pas.

Vullnet Haka – Kur të bëhen pyetje, besoj se do të dalin edhe çështjet e tjera.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Unë mendoj të flasim të gjithë përfaqësuesit e më pas të bëjmë pyetje në mënyrë që të kuptojmë qëndrimet e tyre.

(Diskutime pa mikrofon)

Dionis Teqja – Unë dua ta vazhdoj bisedën, duke u nisur edhe nga komentet që bëri pak më parë kolegu, sa i takon kartës teknologjike që ka çdo biznes. Pra, çdo biznes në momentin që fillon punën në Shqipëri merr nga Ministria e Ekonomisë një leje, e cila është leja për ushtrimin e aktivitetit industrial, ku paraqitet edhe karta teknologjike. Pra, çdo fabrikë e ka kartën e saj teknologjike.

Sa u takon firove, do të doja t’ju bëja disa dallime të vogla për të kuptuar se sa e afekton drejtpërdrejtë koston. Mesatarisht, nga 3 deri në 8 apo 10% janë firo, të cilat nuk janë të riciklueshme, por zhduken, janë avuj.

Arben Ahmetaj – Të cilit produkt?

Dionis Teqja – Të plastikës. Në momentin që plastika kalon në një furrë me temperaturë nga 180 deri në 260°C, pesha e saj ndryshon dhe është rreth 8% në një përqindje të plotë. Pra, kur unë e shes kilogramin, shes 8% më pak...

Arben Ahmetaj – Unë dua të më sillni standardin e industrisë siç i referohet...

Dionis Teqja – Prandaj ju thashë që secili ka kartën teknologjike të miratuar edhe nga Ministria e Ekonomisë...

(Diskutime pa mikrofon)

Patjetër.

E dyta, duke ditur që Shqipëria ka një infrastrukturë shumë të dobët energjetike, Shqipëria dhe prodhuesit shqiptarë afektohen tmerrësisht sa i përket koston së saj përballë konkurrencës rajonale siç janë Maqedonia, Serbia, Kosova apo Italia, sepse këto vende nuk kanë probleme të shkëputjes së energjisë elektrike. Në momentin që energjia elektrike shkëputet në rast se ne nuk kemi gjenerator apo ups deri në 1800 kilovat nuk e mbajmë dot në punë industrinë.

Pra, në këtë mënyrë kemi kosto ekstra, sepse ai skrap i që del, i cili duhet të riciklohet, kalon në tre procese pune dhe automatikisht nga 1 euro kilogrami shkon në 0,2 euro kilogrami.

Arben Ahmetaj – Hidhni në gjyq OSHEE-në dhe mos taksoni shqiptarët indirekt.

Dionis Teqja – Në qoftë se ne duhet të paguajmë 10 studio avokatie për të hedhur në gjyq tatimet, doganat....

Arben Ahmetaj – Mjafton të jeni të rregullt dhe nuk keni nevojë për gjyq.

Dionis Teqja - ... si dhe të hedhim në gjyq qeverinë për ndryshimin e ligjeve sa herë që i tekton pa na pyetur në atëherë i bie që në Shqipëri të mos bëhet fare punë. Puna nuk duhet të shkojë deri te proceset gjyqësore, ne jemi këtu për të bashkëbiseduar...

Arben Ahmetaj – Zoti Teqja, do t'ju ftoj të fokusoheni te propozimi juaj dhe lërnin se si i bënë politikat fiskale qeveria, sepse qeveria i fillon politikat fiskale që në mars dhe i përfundon në dhjetor. Historia e viteve të fundit është e tillë që në vazhdimësi ju jeni dëgjuar, madje ndryshimi erdhi për shkak të kërkesës së shoqatës për 100-lekëshin për kilogram, për t'ju lehtësuar. Megjithatë, le të fokusohemi se çfarë dua unë si kryetar dhe si deputet dhe më pas deputetët e tjerë kanë qëndrimet e tyre. Unë dua argumentim, sepse sot nuk kam ndonjë argumentim ekonomik, ligjor dhe fiskal nga deputeti që ka sjellë propozimin për ndryshim. Mua më duhet t'ia kërkoj argumentimin Ministrisë së Financave, por mendova që të gjithë të dëgjonim argumentimin tuaj, sepse ju jeni industria, sepse nga pretendimi që keni dëmtoheni dhe më pas të dëgjojmë edhe pjesën e importuesve. Për të kuptuar, do të bëjmë edhe krahasimin me ligjet e tjera, siç ndodhë rëndom, por, të lutem, fokusohu te logjika.

Dionis Teqja - Aty isha fokusuar. Thjesht ju dhashë një përgjigje për çështjen e gjyqit, meqë the se e hodhi në gjyq.

Gjithashtu, në rast se do të fokusoheni sadopak në historikun 25-27- vjeçar të organeve doganore, do të arrini të kuptoni se 1 kilogram lëndë e parë që futej në Shqipëri, kishte një referencë nga 700-900 euro toni, dhe 1 kilogram lëndë e parë që futej në Shqipëri, kishte një referencë nga 1300-1600 euro toni, pra institucionet shqiptare kishin punuar gjatë gjithë këtyre viteve për ta ruajtur balancën midis produktit të gatshëm, koston që merrte si produkt i gatshëm dhe lëndës së parë. Pra, përveç kartës teknologjike që ne po ua shpjegojmë se ka disa anë afektive, të cilat e prekin produktin, është edhe kostoja që do të marrë, fitimi, fuqia punëtore, energjia elektrike dhe të gjitha me radhë. Ne nuk po e prekim këtë, por faktin pse afektohet.

Kështu që jam me mendimin e kolegut, që të paktën të rrimë te 5 lekëshi për t'u dhënë mundësi investitorëve shqiptarë...

Arben Ahmetaj - Pse 5?

Dionis Teqja - Po jua argumentoj!

Në rast se nuk do ta bësh 5, por do ta bësh 10, të paktën produktin e gatshëm do ta bësh 40.

Arben Ahmetaj - Pse 10?

Dionis Teqja - Sa e do ti? E doni 3, atëherë produktin e gatshëm bëje 32 lekë.

Arben Ahmetaj - Më falni, se duhet të respektojmë dhe t'i dëgjojmë shoqatat, sepse duhet të kuptojmë edhe argumentet që sjellin, se mund të jenë argumente që na mësojnë për të gjykuar më mirë.

Arsyeja pse unë ju "provokoj", në kuptimin e mirë të fjalës, është që ju të argumentoni edhe një logjikë kosto...

Dionis Teqja - Jua argumentoj unë: në rast se do të ishim në tregun europian, përfshi edhe tregun aziatik, 1 kilogram lëndë e parë, kur futet në fabrikat që kanë ndotje mjedisore, siç janë shishet plastike, ambalazhet, arkat e kështu me radhë, do të paguanin 0.018 euro për kilogram.

Ju e vendosët 200 euro për ton, që i bie 0.2 euro për kilogram. Pra, mesatarisht 25 herë më lartë se çdo shtet i tregut europian. Ndaj diskutimi që bëra dhe çmimi që dhashë nuk u përfrua dhe nuk kishte si bazë krahasimore tregun europian, as atë aziatik.

Arben Ahmetaj - T'ju bëj një pyetje, se na ndihmon logjika juaj: 0.018 euro, si quhet si taksë?

Dionis Teqja - Quhet taksë ambientale dhe është vetëm për fabrikat që prodhojnë materiale ambalazhi.

Arben Ahmetaj - Dakord!

Do t'i lutesha sekretarisë ta mbajnë shënim, që ta verifikojnë.

Së dyti, a ka ndonjë taksë tjetër ambienti, përveç kësaj takse?

Dionis Teqja - Nuk ka asnjë taksë tjetër.

Kini parasysh që unë nuk jam i fokusuar në tregun shqiptar. Unë bëj biznes në Shqipëri, në Europë, në Azi dhe, në qoftë se doni, mund t'ju sjell legjislacionin.

Arben Ahmetaj - Duam që të na ndihmosh me legjislacionin, sepse duam të mësojmë më tepër nga praktika e biznesit. Ju thoni që në Bashkimin Europian ka diferencë midis importit dhe prodhimit vendas.

Dionis Teqja - Nuk ka, ka vetëm referencë. Kostoja e lëndës së parë është jo më pak se 50% më e lartë sesa kostoja e produktit të gatshëm.

Arben Ahmetaj - Zoti Teqja, ju kërkoj ndjesë, ndoshta nuk e bëra unë pyetjen të saktë!

Po e ribëj, se ndoshta ju ndihmoj: ka diferencë në taksimin doganor, duke përfshirë edhe taksën ambientale të plastikës nga importi me Bashkimin Europian me prodhimin vendas?

Dionis Teqja - Në rast se është prodhim vendas, ai zotëria e paguan lëndën e parë kur është i certifikuar si prodhues i materialeve për ambalazhe dhe paguan direkt në doganë. Pra, produkti i gatshëm nuk afektohet fare, se është prodhuar në ato momente.

Arben Ahmetaj - Ka diferencë midis importit dhe granulatit?

Dionis Teqja – Të dyja rastet e paguajnë, por njëri e paguan me një çmim reference...

Arben Ahmetaj - Zoti Teqja, që të më ndihmosh mua të kuptoj atë që thamë: mos hyr te çmimi i referencës, se nuk ka, ka transaksion me çmimin real, por te ngarkesa fiskale a ndryshon?

Dionis Teqja –Nuk ndryshon, por, duke ditur vendet e rajonit dhe kushtet në të cilat ndodhet Shqipëria, është në pozitën dhe dorën tuaj të vendosni nëse doni që në Shqipëri të ketë industri, apo doni që të ktheni Shqipërinë si një shtet që merret vetëm me tregti, me bujqësi dhe kaq.

Arben Ahmetaj - Ky është qëndrim politik. Faleminderit, por nuk jeni të ftuar për qëndrim politik!

Dionis Teqja –Më lejoni ta mbaroj, se unë nuk merrem me politikë!

Arben Ahmetaj - Të pyeta për anën fiskale, jo qëndrim politik, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dionis Teqja –Janë 800 fabrika të afektuara.

Arben Ahmetaj - Zonja Gjylameti, në respekt të punës që bën shoqata edhe investitorët, ju lutem!

Dionis Teqja –Më lejoni ta mbaroj!

Është shumë e vështirë që të mbash në Shqipëri një industri, kur ne kemi harxhuar dhe harxhojmë lekë për të trajnuar staf inxhinierësh teknikë jashtë Shqipërisë. Ndaj jua bëra pyetjen pak më parë: doni ta zhvillojmë industrinë, apo të punojmë në kushte tregtare?

Arben Ahmetaj - Kjo është pyetje politike, që ne i kemi dhënë përgjigje me modelin e ri ekonomik, prandaj edhe rritja e manifakturës ka shkuar me herë dhe eksportet kanë shkuar me 24% të manifakturës dhe 16% të eksporteve totale.

Që ta kuptoj drejt, pyetja është: në qoftë se sot e keni 25 lekë për kilogram, ju nuk konkurrioni dot në tregun ndërkombëtar, dhe në qoftë se bëhet 5 lekë, mund të konkurrioni? Apo nuk është kështu?

Dionis Teqja –Në tregun ndërkombëtar nuk të afekton. Ta argumentoj pse. Ky është një produkt....

Arben Ahmetaj – Ju lutem, kolegë, se sipërmarrësi tha një gjë të rëndësishme! 25 lekëshi nuk e afekton tregun ndërkombëtar të prodhimit të gatshëm kur eksporton.

Dionis Teqja –Sepse është i zbritshëm dhe paguhet nga dogana. Në tregun shqiptar e afekton në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Vullnet, çfarë kishe për të shtuar?

Vullnet Haka – Për sa i përket afektimit në eksport, 25 lekëshin, nëse do të bëhet ndryshimi ligjor, siç është formuluar për të rimbursuar në eksport prodhimin që bëhet këtu me 25 lekëshin, nuk do të afektohen në eksport, jo me ligjin aktual në fuqi, por nëse do të bëhet ky amendimi këtu, atëherë është e vërtetë që nuk do ta afektojë.

Arben Ahmetaj – E saktë!

Pra, ajo logjikë që thoni ju është që, në qoftë se proceduralisht vendosim rimbursimin, niveli fiskal nuk ka ngarkesë.

Vullnet Haka – Për eksportin nuk ka ngarkesë.

Tani të vijmë te çështja e prodhimit vendas dhe ngarkesën që ka në raport me importin. Me sa duket ju e merrni shumë të lehtë faktorin e taksës, pjesës së fshehur të plastikës kur vjen me produktet e tjera, që nuk ka një mënyrë për ta skanuar dhe taksuar në doganë. E vetmja mënyrë është të përdoret një disproporcion i tillë që ne propozojmë.

Arsyeja që ne propozojmë që të përjashtohen disa grupe produktesh zero lekë, të cilët nuk janë plastikë në fund të tyre, apo siç janë profilet e plastikës që kanë një cikël 20 apo 30 vjet që

ndërrohen, ne prodhuesit kemi lënë me mirëkuptim që produktet e plastikës, që kanë një cikël disavjeçar në fundin e jetës së tyre, të kenë një taksë 5 lekë, e cila nuk prish planin e biznesit të investimeve që janë...

Arben Ahmetaj – Që ta sqarojmë propozimin që më ka ardhur nga një deputet, nuk më ka ardhur nga ju, dua që të kuptoj propozimin, gjithë begraundin ekonomik dhe fiskal, t’jua bëj pyetjen që të jem unë më i qartë: ju po sillni dy propozime brenda të njëjtit propozim, të themi, njëra është ulja e 25 në 5...

Vullnet Haka – Bashkimi i Prodhuesve ka këtë propozim që po flasim sot, deputeti ka të vetin. Nuk e di nëse ka dikush tjetër propozim!

Arben Ahmetaj – Ju propozoni që në anën e importit të ketë një këndvështrim të ri...

Vullnet Haka – Në anën e importit, ashtu siç është. Për produktin e gatshëm nuk kemi asnjë propozim, për lëndën e parë, po.

Arben Ahmetaj – Po 51% nga ka dalë?

Vullnet Haka – 51% i propozimit është një detaj teknik, që më tepër i nevojitet doganës apo ministrisë kur të nxjerrë udhëzimin e vet.

Qëndrimi ynë, zoti kryetar, është ky...

Arben Ahmetaj – Më falni, Vullnet, që të sqarohemi bashkë!

Në nenin 1 është propozuar që në rastet kur në artikujt që importohen në kapitullin 39 të nomenklaturës, pjesa joplastike zë më shumë se 51% të masës së përgjithshme, kjo taksë zbatohet vetëm për pjesën e masës plastike. Kjo është e re, le ta themi.

Megjithatë, mbarojeni logjikën tuaja që të kalojmë tek anëtarët e tjerë.

Vullnet Haka – Do të doja të sillja në vëmendje të komisionit edhe një dimension tjetër që ka kjo taksë, e cila ka marrë emrin “taksa e plastikës”, por po të lexosh me vëmendje relacionin që ka sjellë ministria për ta miratuar, është mirëfilli një taksë ambientale për ndikimin që kanë këto produkte në fundin e ciklit të tyre të jetës.

Kjo ishte arsyeja që ne si prodhues, që prodhojmë produkte plastike me një cikël të shkurtër jete, thamë që nuk mund ta çojmë propozimin me zero, por do ta çojmë me një shifër të caktuar, që është ky 5 lekëshi, e cila nuk e afekton industrinë që t’ua prishë planet e biznesit për zhvillim, por shpreh një përgjegjësi për impaktin që kemi.

Duhet të kemi parasysh një gjë: në gjithë volumin e artikujve të produkteve të plastikës, që konsumon shoqëria shqiptare brenda një viti, më shumë se 2/3 vijnë nga importi dhe 1/3

prodhohet në vendin tonë. Është e natyrshme, se ajo që vjen nga importi, duhet të marrë një ngarkesë më të madhe fiskale si taksë ambientale për ta adresuar atë në ripërdorim, riciklim e me radhë, siç janë rregullat e ekonomisë cirkulare...

Arben Ahmetaj – Më falni, t'ju bëj tri pyetje, gjithmonë për të ndihmuar komisionin, kjo është edhe arsyeja e dëgjësës.

E para: sa është sot diferenca midis importit dhe prodhimit vendas?

Vullnet Haka – Është vetëm 10 lekë. 35 lekë është për produktet e gatshme dhe 25 lekë është për lëndën e parë.

Arben Ahmetaj – Po në përqindje, sa është?

Vullnet Haka – 30%.

Është krejt e natyrshme për prodhime që janë bërë në vende të tjera, të cilat, le të themi që benefitet kryesore i kanë lënë atje, kur të vijë këtu, të ketë një taksë ekstra mbi impaktin mjedisor, i cili duhet financuar për të mbyllur ciklin e jetës pas përdorimit të tyre, që duhet të jetë më i ulët sesa ai që prodhojmë këtu. Ky është qëndrimi ynë dhe nuk është diferencë e vogël.

Arben Ahmetaj – Domethënë, diferenca 30% është midis importit dhe vendasit.

Vullnet Haka – Në terma realë është 35 me 25. Përqindjen nuk e di.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti kryetar, kemi edhe një gjë tjetër: një tregtar e ka bërë 3 herë ciklin import: ka sjellë lëndën e parë, e ka depozituar, e ka përpunuar, e ka mbajtur në magazinë, e ka shitur, pra kemi edhe ciklet e qarkullimit që janë në raport 3 me 1.

Arben Ahmetaj – Mos harroni që ne të gjithë, pa përjashtim, aspirojmë Bashkimin European, ku të gjitha këto do të detyrohemi t'i zerojmë dhe është detyra e industrive tona, duke përfshirë edhe plastikën, që të përgatiten për konkurrencën në tregun e hapur.

Unë nuk jam ambientalist dhe nuk marr përsipër të mbaj qëndrim, ndaj po ju bëj edhe pyetjen: një produkt i gatshëm i importuar me një produkt të përpunuar, të dyja në fakt kanë nevojat e depozitimit dhe të shkatërrimit në fund të jetës së tyre, cila nga produktet dëmton më shumë, një që importohet, apo një që prodhohet në vend?

Dionis Teqja – Është në varësi të llojit të produktit.

Arben Ahmetaj – I njëjti produkt, ekzaktësisht.

Dionis Teqja – Në qoftë se është produkt ambalazhi, ka të njëjtin përfundim.

Arben Ahmetaj –Dëmi në ambient është i njëjtë, apo jo? Pse e taksojmë importin më shumë përderisa dëmi është i njëjtë?

Vullnet Haka – Zoti kryetar, këtu nuk flitet për dëm në ambient, se nuk presupozojmë të shkaktojë dëm në ambient, por flitet për vlerën financiare që duhet që ky impakt të mos ndodhë, pra vlera financiare është e njëjtë.

Arben Ahmetaj –Këto të dyja shkojnë në të njëjtën pikë? Unë pyes për të mësuar veten me begraundin, pak më shumë....

Vullnet Haka – Produkti që vjen nga importi duke e marrë të mirëqenë që janë njësoj në përmbajtje. Ky benefitin e ka lënë te prodhuesi i vetë atje.

Arben Ahmetaj –Cilin benefit? Po edhe dëmtimin e ambientit e ka lënë atje.

Vullnet Haka – Benefitet e prodhimit.

Dionis Teqja –Dëmtimi ndodh kur mbyllet cikli i jetës.

Arben Ahmetaj –Edhe kur prodhohet kur ka kimikate, kjo është e pranuar në mënyrë standarde dhe botërisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e papërfillshme? Sa është? Ma sill të shkruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më sill plastikën. Vetëm kaq dua, që ju si biznesmenë të nderuar dhe me sukses të më sillni gjëra të shkruara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Haka – Zoti kryetar, a mundemi të mos bëjmë diskutime duke presupozuar që prodhuesit e plastikës në Shqipëri ndotin ambientin? Është e pakonceptueshme, sepse janë të licencuar...

Arben Ahmetaj –Jo prodhuesit, prodhimi i plastikës.

Vullnet Haka – Për atë ta dhashë përgjigjen, por, nëse mbas asaj përgjigjeje ju thoni se ky prodhuesi këtu, kur prodhon, shkakton edhe ndotje, me këtë nuk bie dakord dhe e quaj të papranueshme për ta vazhduar, sepse presupozojmë që prodhuesit janë të licencuar me leje mjedisore...

Arben Ahmetaj –Vullnet, e drejtoj unë mbledhjen. Unë ju kam ftuar.

Pyetja ime ishte fare e thjeshtë për të kuptuar, ju nxorët konkluzione. Ju po paragjykoni komisionin, ndërkohë që komisioni nuk po e paragjykon fare propozimin tuaj.

Pyetja ime ishte: dëmton prodhimi i plastikës ambientin, apo jo?

Nuk e dëmton.

Mund ta shënojmë në protokoll që të marrim një inxhinier kimist, prodhues i plastikës, që ta pyesim në mënyrë të pavarur dhe t'i dërgojmë një letër ministrisë përkatëse që të na e konfirmojë këtë që thotë industria? Sepse i bie që në këtë logjikë, industria plastike që ka lëndë kimike, nuk e dëmton ambientin, dhe kjo do të ishte në favor shumë të madh tonin edhe për ta mbështetur industrinë e plastikës. Në të njëjtën kohë, i bie që kemi bërë mirë që kemi taksuar importin gati 30% më shumë, seç kemi taksuar prodhimin vendas, por në mënyrë që të vlerësojmë propozimin, duam edhe disa përgjigje zyrtare nga ministria. Është shumë e rëndësishme që ministria të mbajë qëndrim për këtë që ndan industria me ne. Kjo do të ishte një konsekuencë shumë pozitive në qoftë se prodhimi i plastikës nuk e dëmton fare ambientin. Depozitimi dhe shkatërrimi në fund është histori tjetër, pastaj. Por është mirë të bëjmë një letër për ministrinë.

Keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar?....

Vullnet Haka - ...për momentin kjo ishte përgjigjja.

Arben Ahmetaj – Nëse ka pyetje, do t'i përgjigjeni.

Dionis Teqja – Çdo gjë që prodhohet e ndot ambientin, diku në një përqindje më të ulët e diku në një përqindje me të lartë.

Arben Ahmetaj – Zoti Teqja, nuk ka rëndësi, se do të marrim një konfirmim nga Ministria e Mjedisit që të na japin një...

Dionis Teqja - Ajo që tha afekton ju dhe të gjithë popullin. Në ndotjen e ambientit është produkti i gatshëm ai që ndikon, pra të mos i ngatërrojmë gjërat, jo prodhimi i plastikës, jo fabrika, por produkti i gatshëm pasi në det nuk shkon lënda e parë, por shishja, plasmasi

Arben Ahmetaj – Qartë.

Vullnet Haka – Shkon si ai i importit, ashtu dhe ai i prodhimit vendas.

Arben Ahmetaj - Pyetja ishte përtej asaj. Me të drejtë më thatë që një produkt i importuar i njëjtë me produktin e prodhuar e dëmtojnë njëloj ambientin. A çliron në ambient procesi i prodhimit elemente që e dëmtojnë atë, apo jo? Ju më thatë diku jo e diku më pak. Unë, në respekt të punës që bëni, dhe uroj të mos kemi asnjë dëm në mjedis, i kërkoj komisionit që t'i dërgojmë një letër Ministrisë së Mjedisit, me qëllim që ta konfirmojë qëndrimin tuaj, në mënyrë që të na ndihmojë në gjykimin ndaj propozimit të ardhur. Kjo ishte logjika ime.

Vullnet Haka – Zoti kryetar, është një detaj teknik, që është normale që të mos e dini. Që në vitin 2015 qeveria shqiptare i ka konvertuar lejet mjedisore që dispononin njësitë e prodhimit, fabrikat e prodhimit, përfshi dhe ato të plastikës, njëlloj me lejet mjedisore që kanë vendet e BE-së apo homologët tanë atje, ku janë të përcaktuara me detaje të gjitha nivelet e normave të shkarkimeve që kemi dhe nuk ka shanse që të disponosh një leje mjedisore, të kesh standardet e përcaktuara dhe të presupozosh që po ndot. Ne i bëjmë vetë monitorimet dhe raportimet atje çdo 6 muaj dhe nëse do të kishte ndotje atëherë ajo industri apo fabrikë do të ishte mbyllur. Këtu unë marr përsipër të përjashtoj pjesën informale, e cila nuk është objekt bisede sot. Kurse te pjesa tjetër, është e drejta juaj që t'i kërkonit Ministrisë së Mjedisit përgjigje me shkrim, por atë përgjigje e kemi sot këtu të prerë. Nuk shkakton ndotje industria e prodhimit të plastikës.

Arben Ahmetaj – Unë jam shumë i lumtur që ju jeni të bindur! Besoj se kur të marrim konfirmim nga ministria përgjegjëse (se do t'i referohemi institucioneve, biem dakord për këtë, ashtu siç ju referohemi edhe juve entitete dhe institucione të rëndësishme për të vendosur politikat fiskale), do t'i dërgojmë një letër.

Ju faleminderit!

Përfaqësuesja e Dhomës Amerikane e ka fjalën dhe nëse ka pyetje do t'i referohemi.

Alketa Uruçi – Ju falënderoj zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ne i kemi parashtruar komentet e kolegëve tanë në një letër, që ia kemi dërguar edhe komisionit tuaj. Unë do të përpiqem të flas shkurt.

Fillimisht doja të sqaroj që po i referohemi projektligjit, që është depozituar në Kuvend nga deputeti Ilir Beqaj, siç është publikuar në faqen zyrtare të parlamentit. Ky projektligj përmban tri propozime. I pari ka lidhje me taksimin apo mostaksimin e artikujve që importohen në kapitullin 39 të nomenklaturës, ku për pjesën joplastike, ose më shumë se 51% të masës së përgjithshme, kjo taksë zbatohet vetëm për pjesën e masës së plastikës. Nuk kemi asnjë koment në lidhje me këtë dispozitë nga anëtarët tanë. Komentet lidhen me pikën e dytë, pra me ndryshimin e taksës për granulatin nga 25 lekë/kilogram që zëvendësohen me 10 lekë për kilogram. Ky është propozimi i zotit Beqaj.

Sot dëgjuam nga kolegët këtu që propozimi i tyre është të bëhet 5 lekë/kilogramë. Në gjykimin e anëtarëve të Dhomës Amerikane ulja e taksës së plastikës për lëndën e parë nga lekë/kilogram në 10 lekë për kilogramë përbën diskriminim për importet. Pse? Sepse aktualisht

importuesit paguajnë 35 lekë për kilogram për produkt të gatshëm, ndërsa prodhuesit vendas paguajnë 25 lekë për kilogram për lëndën e parë, mbi të cilën ka një proces përpunimi. Nëse do të shihnim relacionin e qeverisë për paketën fiskale 2019, diferencimi në taksim justifikohet me firo teknologjike. Në fakt, siç e dëgjuam edhe sot, firo teknologjike, sipas vetë prodhuesve, janë maksimumi 8 deri në 10%, që do të thotë se përsëri, edhe me normën aktuale të taksimit, prodhimi vendas është i diskriminuar në mënyrë pozitive, sepse diferenca 35 me 25 lekë për kilogram nuk reflekton diferencën në firon teknologjike, që ka granulati në prodhimin e produkteve të gatshme. Rrjedhimisht, duke qenë një taksë në lekë për kilogram nëse nuk justifikohet me firo, ndryshimi në taksim shkon drejtpërdrejt në produktin e gatshëm, pra në çmimin e shitjes së produktit, duke favorizuar në këtë mënyrë dhe duke ulur çmimin e shitjes së produktit të gatshëm të prodhuar në vend krahasuar me materialet ose me produktet...

Arben Ahmetaj – A mund të formuloni edhe ju me shkrim një krahasim për komisionin, siç ia kërkonte Shoqatës së Prodhuesve Vendas? Nuk po them tani. Këtë e them që të kemi rastin e një produkti të njëjtë të importuar dhe të prodhuar për të reflektuar konkretisht atë që pretendoni, pra diferencën në çmim, i cili, në këndvështrimin e të dyja palëve, do të ishte një gjetje interesante për të na ndihmuar si komision. A mund të na jepni një shembull?

Alketa Uruçi – Patjetër, ne do të kontaktojmë me anëtarët tanë.

Arben Ahmetaj – Ta depozitoni tek i njëjti *e-mail*, në mënyrë që ta ndajmë me komisionin dhe ta kemi të qartë.

Alketa Uruçi – Vetëm se kam këtë koment: nuk do ta bënim këtë diskutim sot këtu nëse taksa e plastikës do të paguhej nga prodhuesit vendas mbi produktin e gatshëm dhe jo mbi lëndën e parë.

Arben Ahmetaj – Pse?

Alketa Uruçi – PAGESA mbi lëndën e parë është në njëfarë mënyre, siç e gjykojnë anëtarët tanë, një mbrojtje e qeverisë, për shkak të informalitetit në vend. Si duhet paguar taksa mbi plastikën? Ajo mund të paguhet shumë mirë siç paguhet akciza apo taksa të tjera. Ai që importon material plastik e paguan në doganë, kurse ai që e prodhon materialin plastik e paguan në momentin e shitjes. Në këtë mënyrë, të dyja palët do të aplikojnë të njëjtën masë takse, qoftë 10, 20, 40 apo 100 mbi atë kilogram plastike që kanë prodhuar, i cili do të shkonte te konsumatori dhe nuk do të krijohet diferencim në çmimin final të produktit për shkak të taksës, por do të krijohet për arsye të tjera. Por çfarë ka ndodhur? Për shkak të informalitetit në vend, gjë e cila

është shprehur edhe në relacionin e ndryshimeve në paketën fiskale 2019, për importin e produkteve të gatshme taksa paguhet në doganë, kurse për prodhimin vendas paguhet mbi lëndën e parë. Pastaj del problematika që tha zotëria, që nuk dihet nëse kjo lëndë e parë do të përdoret për të prodhuar këpucë, që nuk janë te kodi 39 i plastikës, tasa plastike apo ambalazhe plastike.

Në këtë pikëpamje, them se i vetmi argument i ndryshimit në taksë ndërmjet produktit të plastikës me lëndën e parë, do të jetë firoja teknologjike. Argumentet e tjera mund të sillen lidhur me faktin që prodhuesit e kanë më të gjatë periudhën e mbylljes së ciklit. E para është e njëjtë për të gjithë prodhuesit në botë, e dyta, justifikohet apo shmanget me faktin se prodhuesit...

Arben Ahmetaj – Zoti Bushati, dhe ju, zoti Xhelili, jeni kthyer në problem serioz për mbarëvajtjen e komisionit. Do t’i kërkoj Kuvendit që të marrë masë ndaj jush. Herën tjerët do të më detyroni që, në bazë të Rregullores, të marr masa, sidomos për ju, zoti Bushati.

Vazhdoni, zonjë!

Alketa Uruçi – Po ju jap një shembull: në Itali taksa mbi ambalazhet plastike aplikohet në të njëjtën masë, pra x euro për kilogram.

Arben Ahmetaj – Sa?

Alketa Uruçi - Ndahen në tri lloje ambalazhesh dhe jo mbi produktet plastike, siç e zgjeruam në këtë vit. Kemi ambalazhet që riciklohen lehtë, që është kategoria e parë, për të cilat shpenzohen 179 euro për ton. Kategoria e dytë janë ambalazhet e riciklueshme, me 280 euro për ton, ndërsa për ambalazhet e pariciklueshme, ose që kërkojnë shumë kohë për t’u ricikluar, shpenzohen 228 euro për ton. Këto janë taksat që mblidhen nga një shoqatë e prodhuesve.

Arben Ahmetaj - A janë njëlloj?

Alketa Uruçi – Është e njëjta taksë.

Arben Ahmetaj – A mund të na e vini në dispozicion, se do të na ndihmonit? Me një skanim ose me një material *hard copy* ta lëmë në komision, se do të na duhet si pjesë e dosjes.

Alketa Uruçi – Po. Këtu thuhet shprehimisht që lënda e parë taksohet njësoj si ambalazhi plastik, duke mos e pranuar idenë e firos në industrinë e prodhimit të produkteve plastike.

Arben Ahmetaj – A jeni ne dijeni të firove në përqindje?

Alketa Uruçi – Jo.

Arben Ahmetaj – Mirë, faleminderit!

Alketa Uruçi – Pika e tretë dhe më e rëndësishmja është se ky diskutim duhej fillimisht të vinte nga qeveria, pra qeveria, nga muaji janar deri në muajin qershor ka bërë një shqyrtim të

paketës fiskale dhe efekteve që ka krijuar. Si propozim i një deputeti të veçantë, them se nuk mund të bëhen politikat fiskale në këtë mënyrë, duke bërë ndryshime me propozime individuale pa e ditur se si, në fakt, ka shkuar puna. Ne vërtet kemi anëtarët tanë, të cilët mund të na japin informacion për importet, çmimet e me radhë.

Arben Ahmetaj – Zonja Uruçi, do t'ju kërkoja që, në respekt të punës suaj, të fokusoheni te çështja! Në bazë të Kushtetutës, deputeti ka të drejtë të bëjë propozim, kështu që fokusohuni te çështja juaj dhe jo te deputeti. Deputeti ka ushtruar të drejtën e vet kushtetuese...

Alketa Uruçi – Doja të thosha që deputeti në relacion thotë: synimi i ndryshimit në 10 lekë për kilogram është incentivimi i prodhimit vendas.

Arben Ahmetaj – Ashtu mendon deputeti në të drejtën e tij, ne po flasim për argumente.

Alketa Uruçi – Një minutë se mbarova. Ky synim bie në kundërshtim me Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, që kemi lidhur me BE-në, por edhe me marrëveshjet e tregtisë së lirë që kemi me vendet e rajonit, CEFTA, EFTA etj, ku ndalohet diskriminimi i produkteve të njëjës palë nëpërmjet masave fiskale. Ne kemi nenin 34 të MSA-së, që flet për ndalimin e këtyre masave.

Arben Ahmetaj – E kam shumë të qartë, sepse kam qenë një nga negociatorët e qeverisë shqiptare.

Alketa Uruçi – Në momentin që do të fillojnë negociatat për hyrjen në BE, patjetër që ky lloj diskriminimi ndërmjet produkteve të importit dhe prodhimit vendas do të dalë në pah.

Arben Ahmetaj – Megjithatë ka një klauzolë në MSA, ku thuhet se autoritetet vendase kanë të drejtë të promovojnë, nëpërmjet diferencimit të kërkesës fiskale, industri specifike me interes kombëtar jo më shumë se me një diferencë deri në 50%. Ajo që ka bërë qeveria shqiptare nuk e tejkalon të drejtën e vet në përputhje me MSA-në. Nuk ju pyeta kot kur ju thashë sa është diferenca mes importit dhe prodhimit vendas.

A keni ndonjë gjë tjetër që doni ta ndani me ne?

Alketa Uruçi - Nuk kam.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Kalojmë në pyetje, por ju lutem t'i bëni të shkurtra dhe specifike, sepse jemi në funksion të industrive për t'i ndihmuar dhe për të kuptuar më mirë se ku qëndron problematika që ata shfaqin. A është legjitime, apo jo? A duhet të avancojmë apo jo me ndryshimin?

Zoti Roshi e ka fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju kërkoj ndjesë pa fund!

Monika Dhamo – Nuk ka problem. Kam vetëm diçka të vogël.

Unë përfaqësoj një grup sipërmarrësish shqiptarë, të cilët merren me importimin dhe prodhimin e dyerve dhe dritareve me profile pvc.

Deri sot ne nuk jemi përfshirë fare në të gjitha diskutimet dhe propozimet e bëra. Së fundmi nga ana e bashkimit të prodhuesve shqiptarë është depozituar një kërkesë në datën 14 qershor në emër të zotërinjve Niko Peleshi, Arben Ahmetaj, dhe Ilir Beqaj në mënyrë që në nenin 2, germa “e”, të shtohet shprehja “të përjashtohen nga taksa prej 35 lekësh për kilogramë profilet PVC që përdoren për prodhimin e dyerve dhe dritareve”. Ku e mbështesim ne këtë kërkesë? Të gjithë ne që prodhojmë në këtë fushë kemi jo më shumë se 15 apo 20 vjet aktivitet. Pra, kjo sipërmarrje ka filluar vitet e fundit, sepse profilet PVC nuk njiheshin më përpara në Shqipëri. Janë profile shumë inovative për sa i përket eficiencës së energjisë në të gjithë Europën.

Në qoftë se do t’i referohemi termoizolimit, efienca në kursimin e energjisë shkon deri në 70% në rastin e dritareve dhe dyerve me PVC. Të gjitha diskutimet e fundit bëhen në drejtim të eficiencës së energjisë.

Së fundi, është bërë një grant nga ana e Bashkimit European, në lidhje me GAF, për të dhënë një kredi të gjelbër rreth 9 milionë euro, e cila jepet nëpërmjet Union Bank dhe Fondit Besa, ku ne jemi pjesë shumë e rëndësishme e saj. Gjithashtu, pushteti lokal na ka ndihmuar duke dhënë rreth 50% në rastin e rinovimeve të të gjithë banesave dhe ndërtimeve, të cilat punojnë me termoizolimin.

Pra, ne gjykojmë që profilet PVC, të cilat përdoren në bërjen e dyerve dhe dritareve plastike, për efekt të frytshmërisë që japin në termoizolim dhe eficiencën e energjisë, duhet të përjashtohen nga kjo taksë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Monika!

Unë kam një koment dhe një pyetje. Më pas do ta marrë fjalën zoti Roshi për të bërë pyetje.

Ju keni shumë të drejtë për eficiencën energjetike, prandaj edhe ne në ligjin për energjitë e rinovueshme kemi bërë subvencionimin direkt të këtyre burimeve. Kështu që, një avantazh legjitim dhe të domosdoshëm e keni marrë nëpërmjet atij ligji. Ju po kërkonit një avantazh tjetër

shtesë fiskal. A mund të na sillni trajtimin e këtyre produkteve në Bashkimin European? Pra, a përjashtohen nga taksa këto produkte në Bashkimin European?

Monika Dhamo – Nuk kanë asnjëlloj takse në Bashkimin European.

Arben Ahmetaj – Nëse mundeni, na sillni referencën ligjore në mënyrë që edhe ne të iluminohe mi. Pra, importi dhe prodhimi vendas i tyre nuk kanë taksa. Do ta vlerësoja shumë nëse do të na sillni në komision ndonjë referencë ligjore europiane dhe pastaj një referencë të një ose dy ligjeve për sa i përket trajtimit.

Faleminderit!

Po, zoti Rosh i. Ju lutem sa më konciz dhe shkurt, gjë që ju karakterizon!

Artur Rosh i – Së pari, nëse ju do të ishit importues, si do ta ndanit taksën midis importit dhe prodhimit vendas?

Së dyti, sa e ndot ambientin një fabrikë çokollatash ose biskotash në raport e fabrikën e plastikës? Çdo proces teknologjik, në një madhësi pambarimisht të vogël, mund ta ndotë ambientin, por nëse këto janë afërsisht të barabarta, nuk ka problem për ne. Pra, sa e ndot ambientin plastika në raport me fabrikën e çokollatave ose biskotave? A jeni ju në pozita të barabarta me importuesit për ndotjen e ambientit, për procesin e fundit e kam fjalën, për rimbledhjen dhe riciklimin e plastikave në fund?

Së fundi, ngaqë më pëlqeu propozimi i Dhomës Amerikane, a jeni dakord ju me Dhomën Amerikane të Tregtisë dhe konkretisht me propozimin e zonjës Uruçi?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zoti Teqja!

Dionis Teqja – Për sa i përket përqindjes, si do të veproja unë nëse do të isha i plotësuar me një rën apo tjet rën palë, kur unë përballem midis të dyve. Po fus pozitën time dhe besoj se në të njëjtën pozitë do të logjikonte secili.

Njëra nga kompanitë e mia quhet “Megatek”, kurse tjetra quhet “Teqja Internacional”. “Megatek” e ka përqindjen e pagesës në doganë për sa i përket taksës ambientale më të lartë sesa përqindja që do të paguante fabrika. Unë, si investitor lokal, po ushtroj të gjithë tryshninë që t’i jap eficiencën apo suportin maksimal industrisë vendase. Pra, unë po e paguaj taksën ambientale dhe do ta paguaj. Në rast se do t’i jepja një argument në shifra Dhomës Amerikane të Tregtisë, ai është shumë i thjeshtë. Një kilogram lëndë e parë plastike kushton 1660 lekë të vjetra ose 166

lekë të reja. Pra. Është 16 herë më e lartë humbja që ne pësojmë sesa taksa që paguan në plastikë importuesi.

Arben Ahmetaj – Mund të na e sillni të argumentuar me shkrim këtë?

Dionis Teqja – Patjetër, sepse kemi faturat e hyrjes në doganë.

Arben Ahmetaj - Nuk është nevoja për faturat, por do t'ju lutesha të na argumentoni me shkrim që ne të iluminohe mi. Na e sillni të shkruar, sepse na ndihmon shumë për të gjykuar për qëndrimet.

Vazhdoni me përgjigjet ju lutem.

Dionis Teqja – Përgjigjen tjetër do ta japë Vullneti.

Arben Ahmetaj – Po, Vullnet.

Vullnet Haka – Për sa i përket pyetjes se sa e ndot ambientin prodhimi në një fabrikë tjetër, në rastin konkret e përpunimit të ushqimeve, çokollatave e të tjera, në raport me atë të plastikës, unë do të thosha që janë të krahasueshme. Nuk ka një diferencë që e ndot më shumë e plastikës apo e ndot më shumë kjo e prodhimeve ushqimore. Kjo ka të bëjë me zbatimin e standardeve që ka leja mjedisore mbi të cilën ai zhvillon aktivitetin. Pra, unë për këtë jam krejtësisht i qartë, i qetë dhe i gatshëm që si komision të bëjmë vizita në impiante të tilla, përjashtuar informalët. Kjo është e padiskutueshme. Rrini të qetë në këtë pikë.

Për sa i përket pjesës tjetër, importit, prodhimit dhe në çfarë raporti qëndrojnë me kontributin në impaktin mjedisor që japin produktet në fundin e jetës së tyre, unë mendoj që prodhuesit i kemi këtu. Si vend, ne nuk shquhemi shumë për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit. Shpresoj që në vitet e ardhshme kjo të zgjerohet dhe konkretizohet me instrumente financiare, sepse fatkeqësisht ne e kemi vetëm të shprehur atje. Ndotësi paguan dhe shumë funksionarë të lartë shtetërorë e keqkuptojnë këtë me pagesën që duhet të paguajë dikush që shkakton një kundërvajtje mjedisore. Në fakt, kjo ka të bëjë me pyetjen që drejtoni ju, zoti deputet.

Bota e zhvilluar e ka adresuar me përgjegjësi të prodhuesit. Sot në Europë quhen “përgjegjësi të zgjeruara të prodhuesit”. Unë mendoj që prodhuesit tanë, meqenëse janë këtu, janë një garanci më shumë për ta mbyllur ciklin.

Prodhuesit që nuk janë në Shqipëri dhe që përfaqësohen këtu nëpërmjet importuesve, të cilët sot janë, por nesër mund të mos jenë, sepse nuk kanë më interesa në atë fushë, nuk i kemi

prezentë në çdo kohë. Pra, krahasimi për sa i përket impaktit pozitiv që mund të japin prodhuesit në këtë fushë është si nata me ditën.

Arben Ahmetaj – Sa përqind e prodhimit të plastikës eksportohet?

Vullnet Haka – Faleminderit që e risollët në vëmendje!

Ju jeni ministri i parë i ekonomisë në Shqipëri që filluat një politikë sektoriale. Nëse keni vëmendje, sollët sektorin e plastikës për arsye se kishte filluar të rriteshin eksportet. Kjo ishte arsyeja që e morët për ta mbështetur kur ishit ministër i Ekonomisë.

Arben Ahmetaj – Sa përqind?

Vullnet Haka – Dua të them që, nëse thamë këtu se është rritur në eksport industria e plastikës, kjo gjë do të vazhdojë të qëndrojë nëse do të ketë prodhim për tregun e brendshëm. Nëse dekurajohet kjo pjesë e industrisë për tregun e brendshëm, natyrisht që do të bjerë edhe trendi rritës në eksport. Unë nuk jam i përgatitur në këtë moment për të dhënë përqindjen, por mund t'ju dërgojmë.

Arben Ahmetaj – Dakord, sepse do të na ndihmonit shumë të kuptonim se çfarë ndodh me prodhimin vendas.

Vullnet Haka - Aq eksponente ka qenë rritja saqë ju si ministri e evidentuat dhe e morët si sektor për ta mbështetur në mënyrë të veçantë.

Arben Ahmetaj – Taksa atëherë ka qenë 100 lekë, imagjinoni tani, që është 35 lekë, çfarë duhet të bëni.

Vullnet Haka – Taksa 100 lekë ka qenë vetëm për ambalazhet njëpërdorimshe. Pra, ajo kishte efekt vetëm mbi 3-4 produkte.

Arben Ahmetaj – Më falni, zoti Xhevit, por po ktheheni edhe ju në problem, si zoti Bushati. Herë tjetër do të aplikohet edhe mbi ju Rregullorja e Kuvendit për prishje të mbledhjes së komisionit!

Po ju bëj një paralajmërim zyrtar zotit Bushati, zotit Xhelili dhe juve.

Faleminderit!

Ka pyetje tjetër?

Nuk ka.

Përveç informacioneve që ju kërkuam (do t'ju lutesha të na i sillni brenda javës), duhet të planifikojmë edhe dy dëgjesa të tjera. Njëra dëgjese do të bëhet me importuesit, kurse tjetra do të bëhet me ekspertë të fushës. Ndërkohë, të lajmërohen shoqatat që të marrin pjesë si dëgjuese,

sepse komisioni mund të vendosë të pyesë edhe industrinë për ndonjë qëndrim që mund të kenë ekspertët, që nuk tingëllon drejt në veshët e prodhuesve apo importuesve, në mënyrë që të krijojmë një zinxhir informacioni që kur të tërhiqemi për të marrë vendim të jemi shumë të qartë.

Dakord.

Faleminderit që na sqaruat dhe punë të mbarë! Unë po dal më i informuar sesa kur hyra, pavarësisht se kam shpenzuar mjaft kohë për ta studiuar kur isha ministër. Besoj se edhe komisionit i vlen.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku neglizhohesh ti.

Ty nuk të ka neglizhuar opozita, jo pozita që e ka për detyrë të të referojë.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti